



NË KËTË NUMËR:

- Ta pastrojmë Kosovën, një tregim suksesi për mbrojtjen e mjedisit
- Krijimi i Sistemit të parë për matjen e gazrave të dëmshme në Kosovë
- Profili i AMMK-së prezantohet në ueb faqen e Rrjetit të Agjencive për Mbrojtjen e Mjedisit (EPA)etwork
- Parku Kombëtarë Malet e Sharrit pjesë e projektit Parqet e Harkut Dinarik
- Rio+20: Time to act for a sustainable future
- Kopenhaga “Kryeqyteti i Gjellbër Evropian”

I nderuari lexues,

Jemi të lumtur që po ndajmë me ju numrin e shtatë të Buletinit Mjedisor. Tema interesante të përzgjedhura nga aktivitetet e grupeve të ndryshme që në fokus kanë mbrojtjen e mjedisit edhe kësaj radhe e kompletojnë përmbajtjen e këtij buletini. Në qendër të vëmendjes kësaj radhe kemi vënë aksionet vullnetare në mbrojtjen e mjedisit e veçanërisht aksionet e pastrimit si dhe punën e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare në përmirësimin e gjendjes së mjedisit në Kosovë.

Nuk mungojnë as informacionet për aktivitetet e nxënësve në projekte mjedisore si dhe pjesëmarrja e institucioneve nacionale në projekte dhe iniciativa regjionale dhe evropiane.

Edhe në këtë numër Ju mund të gjeni këshilla për veprimet që mund të bëhen për të ndihmuar në mbrojtjen e mjedisit, sikurse edhe informacionet e përmbledhura dhe ngjarjet më të rëndësishme nga kalendarit mjedisor i këtij viti.

Duke shpresuar se Buletini ynë është duke përmbushur synimin për ngritjen e nivelit të informimit cilësor për mjedisin falënderojmë të gjithë ata që kontribuuan në pasurimin e këtij numri me tema interesante dhe me interes për publikun.

Edhe më tutje ne i inkurajojmë të gjithë që të na dërgojnë informacionet për aktivitetet e tyre me qëllim që të vazhdojmë këtë bashkëpunim për të pasuruar përmbajtjen e buletinit.

Ekipi Redaktues

TA PASTROJMË KOSOVËN, NJË TREGIM SUKSESI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT



Aksioni gjithëkombëtarë për mbrojtjen e mjedisit me moton “Ta pastrojmë Kosovën” i realizuar gjatë muajit maj, padyshim se është njëri prej aksioneve më gjithëpërfshirëse të realizuara deri më sot në Kosovë. Përveç vullnetarëve të “Let’s do it” dhe punonjësve të MMPH-së, iniciativës iu përgjigjen edhe

shumë qytetarë nga mbarë Kosova. Sipas njoftimeve nga iniciativa “Ta pastrojmë Kosovën”, aksionit iu janë përgjigjur më shumë se 50 mijë vullnetarë nga 37 komuna të Kosovës, me organizimin e aksioneve të pastrimit nëpër qytete, lagje e fshatra me që rast janë grumbulluar më shumë se 10 mijë tone

mbeturina.

Të gjitha pajisjet për mbledhjen e mbeturinave janë siguruar falas nga iniciativa “Ta pastrojmë Kosovën” dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Bëhet e ditur se aksioni “Ta pastrojmë Kosovën”, do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Ai ka për qëllim të inkurajojë mobilizimin e të gjithë qytetarëve, organizatave dhe kompanive të ndryshme për pastrimin e mbeturinave në vendin tonë.

Aksione të ngjashme me moton “Let’s do it”, janë organizuar edhe në shumë vende të botës. Fushata “Let’s do it” ka filluar në vitin 2008 në Estoni dhe me shpejtësi të madhe është shpërndarë në më shumë se 90 vende të botës. <http://letsdoitkosova.org>

INFORMATA TË PËRMBLEDHURA

Nga territori i Kosovës gjatë viteve me lagështi mesatare rrjedhin 3.6 miliard m³ ujë.

Në Kosovë nuk ekziston shpërndarje e barabartë e resurseve ujore. Rrafshi i Kosovës cili ka rreth 60 % të popullsisë së Kosovës, ka rreth 38.8% të sasisë së përgjithshme të rezervave ujore, kurse rrafshi i Dukagjinit ku jetojnë rreth 40% e popullsisë ka rreth 61.2 % e rezervave ujore.

Pjesa qendrore e fushëgropës së Kosovës ka sasi të ujit 2 l/s/km² ndërsa rrjedha e sipërme e Lumëbardhit të Deçanit (rrafshi i Dukagjinit) ka ujë deri në 53 l/s/km²

Ndotja më e madhe e lumenjve në Kosovë shkaktohet pas kalimit të tyre nëpër qendrat e mëdha urbane që njëherit janë edhe qendra industriale të cilat në lumenj i derdhen ujërat e ndotura urbane dhe industriale.

KRIJIMI I SISTEMIT TË PARË PËR MATJEN E GAZRAVE TË DËMSHME NË KOSOVË

Raporti i Zhvillimit Njerëzor të UNDP vlerëson se stabilizimi i përqendrimit të gazrave të që dëmshme (GHG) në atmosferë në atë nivel që parandalon ndikimin për ndryshime të mëdha të klimës mund të kërkojë reduktim 50% të lëshimit të gazrave të dëmshme deri në vitin 2050 nga nivelet e vitit 1990. Kjo është sidomos relevante për rajonin e Ballkanit, që ka disa nga ekonomitë të cilat shkaktojnë shumë karbon dhe ndryshimet e klimës tashmë po shkaktojnë ndikime të mëdha në zhvillim. Tashmë është krijuar sistemi i parë në Kosovë për matjen e gazrave të dëmshme që do të përllogarisë të gjithë gazrat që ndikojnë në efektin serë të cilat

prodhohen në Kosovë. Sistemi i parë është zhvilluar nga një ekip i ekspertëve nga Çekia në bashkëpunim me ekspertë nga Kosova; dhe është përkrahur nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në Kosovë me kontribut nga qeveria e Çekisë. Sistemi për matjen e gazrave të dëmshme (GHG) është një mekanizëm që regjistron dhe monitoron lëshimin e gazrave që shkaktojnë efektin serë. Gazrat e efektit serë janë burimi kryesor për ngrohjen globale dhe ndryshimet e klimës. Në Kosovë, burimi kryesor i gazrave të dëmshëm është sektori i energjisë, “aktivitete me ndezje karburanti” që përbëjnë rreth 80% të të gjitha lëshimeve antropogjene në Kosovë.

Sistemi do të menaxhohet nga Agjensia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit (AKMM) dhe do të përdoret për të raportuar tek organe të brendshme dhe të jashtme me qëllim të politikave zhvillimore, debeteve politike dhe monitorim të politikave. Në kontekst të marrëveshjeve ndërkombëtare gjithnjë e më shumë për reduktimin e lëshimit të gazrave dhe masave për zhvillim mjedisor, prezantimi i sistemit matës GHG në Kosovë vjen në kohën e duhur dhe do të përkrahë objektivat e zhvillimit mjedisor në Kosovë si dhe do të kontribuojë në axhendën ndërkombëtare për ndryshimin e klimës.”

PROFILI I AMMK-SË PREZANTOHET NË UEB FAQEN E RRJETIT TË AGJENCIVE PËR MBROJTJEN E MJEDISIT (EPA)ETWORK

NETWORK OF THE HEADS OF ENVIRONMENT PROTECTION AGENCIES



Në buletin informativ të publikuar nga EPA Network është konfirmuar edhe zyrtarisht se profili i Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës është postuar në ueb faqen e këtij rrjeti si anëtarë me të drejta të plota. AMMK është anëtarë i 38 i këtij rrjeti joformal i cili mbledh rreth vetës të gjithë udhëheqësit ose drejtorët e Agjencive Nacionale për Mbrojtjen e Mjedisit ose institucioneve të ngjashme të vendeve evropiane. Në profilin

e prezantuar i cili mund të shikohet duke klikuar në linkun: http://epanet.ew.eea.europa.eu/european_epas/countries/kosovo, ka informacione për themelimin, historikun, organizimin, detyrat dhe përgjegjësitë e AMMK-së. Po ashtu AMMK është ftuar të marrë pjesë edhe në takim të radhës së EPA Network i cili do të mbahet me 27-29 shtator në Sofje të Bullgarisë. Qëllimi i kryesor i këtij rrjeti është shkëmbimi i pikëpamjeve dhe përvojave

për çështjet dhe interesat e përbashkëta të organizatave pjesëmarrëse në implementimin praktik të politikave mjedisore. Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës shpreson që përmes anëtarësimit në këtë rrjet të rëndësishëm mjedisor të përfitojë përvoja nga vendet evropiane në implementimin e legjisllacionit mjedisor si dhe të rrisë bashkëpunimin me Agjencinë tjera evropiane të mjedisit. www.epanet.ew.eea.europa.eu

SI MUND TË NDIHMOJMË NË MBROJTJEN E MJEDISIT?



♻️ Ndhimo ne mbrojtjen e mjedisit. Përdorni sa me pak qese të plastikës.



♻️ Kur udhëtoni në distanca të shkurta, përdorni bicikletën ose ecni në këmbë.

PROJEKT PËR MJEDISIN NGA NXËNËSIT E KOLEGJIT MEHMET AKIF NË KOSOVË



Dy nxënës të Kolegjit Turk "Mehmet Akif" në Kosovë, kanë fituar medaljen e bronzë në Olimpiadën e kolegjeve, përmes projektit në lëmin e mjedisit. Nxënësit Jon Maxhuni dhe Diedon Xhiha, në olimpiadën e mbajtur në Houston-Texas në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, prezantuan projektin e tyre, në mesin e 438 projekteve të tri lëndëve të ndryshme: energji, inxhinieri dhe mjedis. Nxënësit, të cilët i prezantonin këto projekte, përfaqësonin më shumë se 100 shtete nga e gjithë bota. Nxënësit nga Kosova arritëm që të fitojnë

medaljen e bronzë, duke e zënë kështu vendin e tretë dhe po ashtu fituan një bursë që mbulon 50 % të shpenzimeve për studime universitare. Joni dhe Diedoni përmes projektit të tyre kanë prezantuar mundësinë e pastrimit të ujit të ndotur të minierës së Trepçës, përmes lëvizhës së bananes, si substancë e tharë. Edhe pse Miniera e Trepçës aktualisht nuk funksionon, ajo për shkak të posedimit të metaleve të rënda si: zinku, plumbi dhe kadmium, është burim potencial për ndotjen e ujërave sipërfaqësore përreth, dhe

shfaq probleme për mjedisin dhe për njerëzit në rrethinë. Duke u nisur nga kjo informatë nxënësit kanë nisur projektin e tyre. Më tutje, ata pas shumë hulumtimeve të literaturës dhe referencave në internet, kanë parë se lëvizhja e bananes ka aftësi të absorbojë pastrimin e joneve të këtyre metaleve, meqë lëvizhja përmban proteina dhe nisheste. Në fillim, ata kanë përdorur bananan e tharë e pastaj e kanë grimtuar në copa shumë të imëta, pasi që banania e tharë nuk përmban lëngje dhe mund të absorbojë më tepër. Pas kësaj, këto grimca janë përzier me një sasi 100 mililitra të ujit të ndotur të Trepçës, dhe kështu janë fituar filtratet, të cilat pastaj janë dërguar për analiza në laborator. Pas analizave janë nxjerr rezultate shumë të mira për aftësinë e absorbimit të këtyre joneve metalike të rënda nga uji i Trepçës, nga filtratet e bananes.

PARKU KOMBËTAR MALET E SHARRIT PJESË E PROJEKTIT PARQET E HARKUT DINARIK



Parku Kombëtar "Malet e Sharrit" është bërë pjesë e një projekti trevjeçar për Parqet e Harkut Dinarik. Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës është partner në implementimin e këtij projekti të menaxhuar nga WWF Mediterranean (Fondi Botëror për Botën e Egër për Mesdheun) me mbështetjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme

të Norvegjisë dhe fondacionit MAVA. Projekti ka për qëllim të formojë një rrjet të Parqeve Nacionale dhe Parqeve të Natyrës në Harkun e Maleve Dinarike. Në projekt janë përfshirë rreth 80 zona të mbrojtura nga Sllovenia, Kroacia, Bosnja e Hercegovina, Serbia, Mali i Zi, Kosova, Maqedonia dhe Shqipëria. Në

kuadër të këtij projekti gjatë vitit 2012 janë mbajtur disa trajnime dhe vizita studimore në vendet e rajonit, ndërkohë që rrjeti planifikon të organizojë edhe konferenca, punëtori, seminare dhe shkëmbim përvojash në lëmin e NATURA 2000, ekoturizmit dhe gjetjen e fondeve për mbrojtjen e natyrës. Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës përmes njësisë të saj: Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Drejtoria a Parkut Nacional Mali Sharr pret që nga ky projekt të përfitojë përvoja në sektorin e menaxhimit të zonave të mbrojtura në përgjithësi dhe të parqeve nacionale në veçanti. Gjithashtu kjo është një mundësi e mirë edhe për thellimin e bashkëpunimit rajonal në shkëmbimin e përvojave të mira në mbrojtjen e natyrës dhe në ngritjen e kapaciteteve për përfitimin e fondeve të Bashkimit Evropian për mbrojtjen e natyrës.

KALENDARI MJEDISOR

16 Shtator
Dita Ndërkombëtare për ruajtjen e shtresës së Ozonit

18 Shtator
Dita Botërore e monitorimit të ujit

22 Shtator
Dita Botërore e Qyteteve të Pastërta

4 Tetor
Dita Botërore për Mbrojtjen e Kafshëve

15 tetor
Dita Ndërkombëtare e Ecjes në Natyrë

16 Tetor
Dita Botërore e Ushqimit

8 Nëntor
Dita Ndërkombëtare e Zonave Urbane

Ky bulletin botohet në bashkëpunim mes Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë (MMPH) dhe Programit të Kombeve të Bashkuara (UNDP) në Kosovë.

Ekipi redaktues:
Afrim Berisha (MMPH),
Sami Behrami (MMPH),
Inari Penttilä (UNDP) dhe
Burbuqe Dobranja (UNDP).

Për numrin e radhës abonohu në:
www.ks.undp.org

Versioni online në:
<http://www.kosovo.undp.org/>
dhe
www.ammk-rks.net

RIO+20: KOHA PËR TË VEPRUAR PËR NJË TË ARDHME TË QËNDRUESHME

Konferenca Rio+20 për zhvillimin e qëndrueshëm që u mbajt në Rio de Janeiro, Brazil në qershor 2012 ka qenë konferenca më e madhe e OKB-së që është mbajtur ndonjëherë dhe një hap madhor drejt arritjes së një të ardhmeje të qëndrueshme.

E treta e këtij lloji, kjo mbledhje ndërkombëtare e nivelit të lartë u organizua me qëllim të drejtimit dhe ripërtëritjes së zotimit politik global ndaj tri dimensioneve të zhvillimit të qëndrueshëm: rritja ekonomike, përmirësimi social dhe mbrojtja e mjedisit; duke u përqendruar tek ulja e varfërisë përmes promovimit të punëve të gjelbra, energjisë së pastër dhe përdorimit më të drejtë dhe

të qëndrueshëm të burimeve. Konferenca ishte vijim i Samitit të Tokës të vitit The 1992 ku u caktuan konventat kyçe për ndryshimin e klimës dhe biodiversitetin si dhe u dhanë zotime për zhdukjen e varfërisë dhe drejtësinë sociale. Mirëpo që atëherë, lëshimi global i gazrave është rritur me 48%, 300m hektarë pyje janë spastruar dhe popullsia është rritur me 1.6 miliardë banorë. Pavarësisht zbutjes së varfërisë, një në gjashtë njerëz është i keqshqyer.

Përfaqësues të 192 vendeve anëtare të OKB-së — përfshirë 57 drejtues të shteteve dhe 31 kryetarë të qeverive, kompanive të sektorit privat, OJQ-ve dhe grupeve të tjera morën pjesë në

konferencë duke e çuar numrin e përgjithshëm në më shumë se 45 mijë pjesëmarrës individualë. Pjesëmarrja virtuale në Konferencë gjithashtu ishte e madhe, pasi media sociale luajti një rol të madh në ngritjen e vetëdijësisë dhe mundësisë të pjesëmarrjes më të madhe në mbarë botën. Në përfundim të konferencës tre-ditore, udhëheqësit botërorë miratuan dokumentin që rezultoi për konferencën Rio+20, të titulluar “E ardhmja që dëshirojmë” që bën thirrje për një shkallë më të gjerë të veprimeve dhe bizneset e investitorët u zotuan të apin më shumë se 50 miliardë dollarë për të arritur tre objektivat e kësaj nisme.

KOPENHAGA “KRYEQYTETI I GJELBËR EVROPIAN”

Qyteti danez i Kopenhagës ka fituar Çmimin Kryeqyteti i Gjelbër Evropian. Kopenhaga u zgjodh për arritjet në “eko risi-dhe lëvizshmëri të qëndrueshme” për faktin e të qenit një model për ekonominë e gjelbër në Evropë dhe për angazhimin që qytetarët të ndihen pjesë e zgjidhjes së gjelbër. Çmimi Kryeqyteti i Gjelbër Evropian ka për qëllim që ti bëjë qytetet evropiane vendet më të këndshme për të jetuar, punuar, dhe për t'u vizituar. Sot, tre nga katër evropian jetojnë në qytete. Çmimi u krijua nga BE-ja për të shpërblyer shembujt më të mirë të trajtimit të sfidave mjedisore që vijnë me jetën moderne urbane. Juria veçoi Kopenhagën si një model në planifikimin dhe projektimin urban. Kopenhaga ka vendosur partneritetet publike-private në thelbin e qasjes së tij ndaj eko-risive dhe lëvizshmërisë së qëndrueshme.



Qyteti punon me kompanitë, universitetet dhe organizatat për të zhvilluar dhe zbatuar rritjen e gjelbër. Ai është gjithashtu një pionier në transport, me qëllim që të bëhet qyteti më i përdorshëm në botë për çiklistët. Synimi është që deri në vitin 2015, më shumë se 50 % e banorëve

të tij të përdorin biçikletën për të shkuar në punë apo në shkollë (35 % tashmë e bëjnë këtë, që nga 2010), duke ndihmuar qytetin në arritjen e qëllimit të tij ambicioz për të qenë CO₂ neutral deri në vitin 2025. http://www.enn.com/green_building/article/44641

SI MUND TË NDIHMOJMË NË MBROJTJEN E MJEDISIT?

♻️ Rregulloni kronin që pikon dhe kurseni rreth 30 litra ujë në ditë.



♻️ Nëse e ndalim kronin derisa pastrojmë dhëmbët do të kursejmë rreth 20 litra ujë.



♻️ Përdor poçat eficient elektrik dhe ndihmo në kursimin e energjisë.